



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.29, datë 24.02.2022

PËR NDËRPRERJEN DHE PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKUROREN FAHRIJE VATA, KANDIDATE PËR POZICIONIN E DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KUKËS

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a”, 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në germën “ç”, të pikës 4, të nenit 32 dhe nenit 52, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në germën “c”, të pikës 14 dhe pikën 16, të Seksionit B, të Kreut VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Për ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, figurës për prokuroren Fahrije Vata, candidate për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokuroren Fahrije Vata, candidate për pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Të njoftohet për këtë vendim znj. Fahrije Vata.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**





ANËTAR
SOKOL STOJANI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
LUDOVIK DODA

ANËTAR
ZEQIR HODA

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ